

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO MINISTRIA E PUNEVE TE JASHTME - MINISTARSTVO INDIKSTRANOSNOVA - MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS SEKTORI I ARKIVES - SEKTOR ARHIVE - ARCHIVE SECTION			
Njësia Org. Org. Unit	2.0.	Nr. Prot. Broj Prot	169
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	02.	Data: Datum Date	19/02/2014
Prishtine / a			



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO AGJENCIA SHQETETORE PER MBROJTJEN E TE DHENAVE PERSONALE DRZAVNA AGENCIJA ZA ZAŠTITU LICNIH PODATAK NATIONAL AGENCY FOR PROTECTION OF PERSONAL DATA ZYRA E ARHIVIT - RANGELARNA ARHIVA - ARCHIVE OFFICE			
Njësia Org. Org. Unit	01	Nr. Prot. Broj Prot.	19
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	02	Data: Datum Date	13/02/2014
PRISHTINE / A			

**Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo**

Në bazë të nenit 12.2, 12.3 dhe 14.2 të Ligjit Nr.03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë si dhe në bazë të nenit 23.3 paragrafi i dytë i Ligjit nr.04/L-042 për prokurim publik, lejohet të lidhin këtë marrëveshje mirëkuptimi për përkrahje dhe asistencë teknike për Agjencinë Shtetëror për mbrojtjen e të dhënave nga personeli i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës dhe për këtë lidhim këtë:

Marrëveshje Mirëkuptimi

**ndërmjet
Agjencinë Shtetëror për mbrojtjen e të dhënave personale
dhe
Ministria e Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës**

**Neni 1
Qëllimi**

Kjo marrëveshje e mirëkuptimit (MIM) e nënshkruar ndërmjet, Agjencisë Shtetëror për mbrojtjen e të dhënave personale dhe Ministria e Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës është marrëveshje ndërmjet këtyre dy institucioneve të pavarura më qëllim të përkrahjes teknike dhe profesionale nga stafi i MPJ-së, Agjencinë Shtetëror për mbrojtjen e të dhënave personale, në lëmin e prokurimit.

**Neni 2
Shfrytëzimi i kontratave**

Agjencinë Shtetëror për mbrojtjen e të dhënave personale në bazë të kësaj marrëveshje i lejohet të shfrytëzoj kontratat e Ministria e Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës në fushën e Prokurimit për furnizimet dhe shërbimet e kontratave kornizë, të nënshkruara ndërmjet MPJ-së dhe Operatoreve Ekonomik, ndërsa pagesat do të ekzekutohen nga buxheti i Agjencisë.

**Neni 3
Realizimi i shërbimeve**

Realizimi i të gjitha kërkesave për furnizimet, shërbimet dhe punët do të bëhen në pajtim me kërkesat e LPP-së dhe do të udhëhiqen nga zyrtari i certifikuar në prokurim i Ministria e Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës, i cili do jetë në bashkëpunim të plotë me zyrtarin kryesor autorizues të Agjencisë, kurse Agjencia duhet ti kompensoj një pagesë shtesë si stimulim për kryerjen e këtyre shërbimeve. Agjencia gjatë kësaj kohe duhet të ngritë kapacitetet e stafit të vetë për realizimin e shërbimeve, bazuar në Ligjin mbi mbrojtjen e të dhënave personale dhe në mundësinë e parë do të autorizoj personelin e Agjencisë në kryerjen e këtyre procedurave ligjore.

Neni 4
Afati i MiM-it

Ky memorandum hyn në fuqi nga momenti i nënshkrimit deri me 31.12.2014 dhe hartohet në katër kopje, ku nga dy kopje u mbeten palëve.

Prishtinë, me 12/02/2014

Ministria e Punëve të Jashtme
e Republikë së Kosovës

UD Sekretare e Përgjithëshme
Mirjeta Behluli



Agjencia Shtetërore për mbrojtjen e të dhënave
Personale

Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror
Ruzhdi Jashari

